

Vendim nr. 340, datë 29.12.2025

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Asim Vokshi, Marsida Xhaferllari, anëtarë, në datën 29.12.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (Z) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: ZYRA PËRMBARIMORE PRIVATE “ARB” SH.P.K.,
përfaqësuar nga administratori Alban Ruli.

OBJEKTI: Rihapja e proceseve gjyqësore të përfunduara me vendimet nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese dhe nr. 56, datë 20.05.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Shfuqizimi i vendimeve nr. 33, datë 01.11.2021 dhe nr. 56, datë 20.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese dhe pranimit të kërkesës. Konstatimi i mungesës së një mjeteve efektive për dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave gjyqësore. Konstatimi i statusit të “viktimës”, si rrjedhojë e shkeljes së aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj dhe afatit të arsyeshëm. Rehabilitimi dhe zhdëmtimi në përputhje me ligjin për dëmin e shkaktuar nga vendimmarrjet e Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, pika 2, 42, 116, pika 1, shkronja “b”, 122 dhe 131, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 13, 19 dhe 46 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 71/c i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është palë paditëse në një proces gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, me objekt shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të pësuar, fitimin e munguar, si dhe për kamatat ligjore përkatëse. Mbi bazën e rekursit të kërkueses, çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 14.09.2017.

2. Kërkuesja, bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), në datën 14.12.2020 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të shqyrtimit të rekursit të saj (*kërkesa për përshpejtimin e procedurave*). Kërkesa nuk është marrë në shqyrtim brenda afatit ligjor 45-ditor dhe për këtë shkak, në datën 21.04.2021, ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*). Kjo e fundit, me vendimin nr. 33, datë 01.11.2021 (*vendimi nr. 33/2021*) ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se pretendimi për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosshqyrtimit të rekursit brenda një afati të arsyeshëm, ishte i pabazuar, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, interesin e kërkueses që nuk rrezikohej në shkallë të konsiderueshme, si dhe numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë, në pritje për t'u gjykuar nga një numër i reduktuar gjyqtarësh.

3. Pas publikimit të vendimit të Gjykatës, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 6, datë 16.12.2021 (*vendimi nr. 6/2021*), ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e procedurave, me argumentin se tejzgjatja e afatit të çështjes ishte rrjedhojë e "*pamundësisë objektive*". Në datën 07.03.2022 kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 6/2021 të Gjykatës së Lartë. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 56, datë 20.05.2022 (*vendimi nr. 56/2022*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim, me arsyetimin se kërkuesja nuk kishte paraqitur ndonjë argument që të tregonte ndryshimin e situatës dhe të interesit të saj nga koha e dhënies së vendimit nr. 33/2021, që të ishte me rëndësi të mjaftueshme për të ndryshuar arsyet që qëndronin në themel të vendimmarrjes së mëparshme të Gjykatës.

4. Ndërkohë, kërkesja i është drejtuar edhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) me dy kërkesa. Midis tyre, *kërkesa e dytë*, e regjistruar me nr. 38996/20, datë 21.12.2019, i përkiste procesit gjyqësor, për të cilin ishte dhënë vendimi nr. 33/2021 nga Gjykata (shih paragrafët 28 – 34 të vendimit të GJEDNJ-së që i përket çështjes ARB sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 27.05.2025). Në përfundim të shqyrtimit, GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 27.05.2025, për kërkesën e dytë, ka konkluduar se, duke pasur në konsideratë periudhën prej 7 vjetësh, gjatë së cilës çështja ishte në pritje për t’u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë (shih paragrafin 31 të vendimit të GJEDNJ-së), ishte shkelur kërkesa për “afat të arsyeshëm” sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së (shih paragrafin 129, po aty). Ndërsa për sa i takon pretendimit të kërkuësës se nuk kishte asnjë mjet efektiv për ankesat e saj për kohëzgjatjen e procedurave, çka për pasojë ka sjellë cenimin e nenit 13 së bashku me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja e ka vlerësuar atë si qartazi të pambështetur në fakte, rrjedhimisht të papranueshme sipas nenit 35, paragrafi 3, shkronja “a”, të KEDNJ-së, ndaj e ka rrëzuar këtë pretendim sipas nenit 35, paragrafi 4, po të KEDNJ-së (shih paragrafin 170 të vendimit të GJEDNJ-së).

5. Sipas GJEDNJ-së, pyetja që kërkonte përgjigje sipas nenit 13 së bashku me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së kufizohej në faktin nëse kërkesja e ka pasur mundësinë që mbështetur në legjislacionin vendas të ankohej për kohëzgjatjen e procedurave dhe për këtë Gjykata ka shqyrtuar ankesën e kërkuësës për kohëzgjatjen e procedurave, duke pasur në konsideratë faktorët që përfshijnë arsyet për vonesën, sjelljen e autoriteteve dhe të kërkuësës, kompleksitetin e çështjes dhe çfarë ishte në rrezik gjatë procedurave. GJEDNJ-ja, pavarësisht konstatimit të shkeljes së nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, ka vënë në dukje se në çështjen konkrete kërkuësës i ishte dhënë mjeti efektiv për pretendimet e saj për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave (shih paragrafin 169 të vendimit të GJEDNJ-së, i cili referon te paragrafët 161 – 166, po aty). Në përfundim, GJEDNJ-ja, i ka akorduar kërkuësës vlerën e dëmit jopasuror sipas kërtimeve të saj (në masën 2400 euro), si dhe kostot e shpenzimit (në masën 1500 euro), duke refuzuar kërkimin për dëmin pasuror, pasi nuk ka gjetur ndonjë lidhje shkakësore midis shkeljeve të konstatuara dhe dëmit të pretenduar (shih paragrafët 183 – 184 të vendimit të GJEDNJ-së). Vendimi i GJEDNJ-së është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 163, datë 15.09.2025.

6. Në datën 15.10.2025 kërkesja ka paraqitur sërish ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkueses

7. *Kërkuesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se kërkimet e saj bazohen në vendimin e GJEDNJ-së dhe në detyrimet e shtetit shqiptar si anëtare e Këshillit të Evropës për zbatimin e vendimeve përfundimtare të asaj gjykate. Sipas saj, Gjykata duhet të konsiderojë vendimmarrjen e GJEDNJ-së për eliminimin e statusit të “viktimës”, duke akorduar edhe dëmshpërblimin e arsyeshëm në përputhje me nocionin e *restitutio in integrum*.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkueses

8. Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se, mbështetur në nenin 5 të Kushtetutës, vendimet e GJEDNJ-së janë të detyrueshme për t’u zbatuar, në përputhje me angazhimin që Republika e Shqipërisë, si shtet anëtar i Këshillit të Evropës, ka ndërmarrë sipas nenit 46, pika 1, të KEDNJ-së, që parashikon se palët e larta kontraktuese zotohen t’u binden vendimeve përfundimtare të GJEDNJ-së në mosmarrëveshjet në të cilat janë palë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 20, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në përputhje me këtë detyrim, sipas nenit 71/c të Ligjit Organik të Gjykatës, nëse GJEDNJ-ja gjykon një çështje (për të cilën ka vendosur më parë Gjykata) dhe konstaton se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, individit, në favor të të cilit ka vendosur GJEDNJ-ja, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor (*pika 3*). Kërkesa për rihapje paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare dhe duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, kërkimet konkrete dhe kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit, si dhe shfuqizimin e aktit (*pika 4*). Kur Gjykata e pranon kërkesën, ajo vendos shfuqizimin e vendimit të mëparshëm të saj dhe pranimin e kërkesës (*pika 6, shkronja “a”*) ose shfuqizimin e vendimit të mëparshëm të saj dhe njëkohësisht të aktit që ka cenuar të drejtat dhe liritë themelore të kërkuesit dhe detyrimin e organit kompetent të nxjerrë një akt të ri ose detyrimin e organit të mos veprojë, sipas rastit (*pika 6, shkronja “b”*). Qëllimi i kërkesës për rihapjen e procesit është rivendosja e individit në situatën që ishte përpara shkeljes së konstatuar, ndaj një kërkesë e tillë nuk përbën ankim të ri kushtetues, me të cilin individit mund të paraqesë shkaqe të reja ose të ndryshme nga ato që ka paraqitur në ankimin fillestar. Vendimi për

rihapje merret Kolegji, Mbledhja e Gjyqtarëve ose Gjykata që ka dhënë vendimin në procesin që kërkohet të rihapet (*shih vendimin nr. 67, datë 06.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, e cila në objektin e saj përmban 5 kërkime kryesore: (i) rihapjen e procesit; (ii) shfuqizimin e vendimeve nr. 33/2021 të Gjykatës dhe nr. 56/2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; (iii) konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për dëmshpërblimin dhe përsheptimin e procedurave; (iv) konstatimin e statusit të “viktimës”; (v) rehabilitimin dhe zhdëmtimin në përputhje me ligjin. Kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 15.10.2025, pra brenda afatit ligjor 4 mujor, i cili ka filluar të ecë nga data 15.09.2025, kur vendimi i GJEDNJ-së ka hyrë në fuqi (*shih supra paragrafët 5 dhe 6*). Në përmbajtjen e kërkesës, kërkuesja ka paraqitur një përmbledhje të vendimit të GJEDNJ-së me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, si dhe kërkimet që lidhen me pretendimin kryesor për rehabilitimin dhe zhdëmtimin e saj si pasojë e vendimmarrjes së kësaj Gjykate.

11. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuesja formalisht ka përmbushur pjesërisht kriteret për legjitimitimin e saj në kërkimin e saj për rihapjen e procesit, pasi ajo ka qenë palë në dy procese të zhvilluara në Gjykatë, për të cilat është zhvilluar edhe procesi në GJEDNJ dhe kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor. Ndërkohë, për sa i takon përmbajtjes së pretendimeve ato në thelb lidhen me kërkimin për njohjen e statusit të viktimës dhe akordimin e dëmshpërblimit. Mirëpo, nga përmbajtja e vendimit të GJEDNJ-së rezulton se këto kërkime kanë qenë çështje që janë trajtuar edhe prej saj dhe ajo ka vlerësuar se kërkueses i ishte dhënë një mjet efektiv për pretendimet e saj për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave. Ajo gjykatë ka çmuar se cenimi i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm ka ardhur si shkak i mosveprimit të Gjykatës së Lartë për një periudhë prej 7 vjetësh, duke konstatuar në këtë mënyrë shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, ndaj i ka akorduar kërkueses dëmshpërblim, duke i njohur vetëm dëmin jopasuror në vlerën 2400 euro dhe kostot e shpenzimit në vlerën 1500 euro, plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme. Ndërkohë, për sa i takon dëmit jopasuror të pretenduar, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se nuk ka gjetur ndonjë lidhje shkakësore midis tij dhe shkeljeve të konstatuara (*shih supra paragrafët 4 dhe 5*). Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ka nxitur autoritetet shqiptare të marrin masat e nevojshme për t’i siguruar gjyqësorit burimet e nevojshme, me qëllim adresimin e sfidave për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, por edhe për të përmirësuar në praktikë efikasitetin e mjetit kompensues sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së.

12. Në analizë të çështjes konkrete, Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se GJEDNJ-ja e ka konstatuar shkeljen e së drejtës së kërkueses për proces të rregullt ligjor në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme, duke i njohur për këtë qëllim edhe shpërblimin e dëmit jopasuror dhe vendimi i saj (GJEDNJ-së) është i detyrueshëm për zbatim. Kjo gjë i është vënë në dukje kërkueses edhe më herët nga Gjykata, që ka evidentuar se e drejta themelore e saj është rivendosur tashmë nga GJEDNJ-ja, e cila jo vetëm ka konstatuar shkeljen e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit në Gjykatën e Lartë, por i ka njohur edhe shpërblimin e drejtë për dëmin e shkaktuar nga kjo vonesë (*shih paragrafin 27 të vendimit nr. 52, datë 07.10.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se qëllimi i kërkueses për vënien në lëvizje të Gjykatës është përmbushur tashmë nga GJEDNJ-ja. Për rrjedhojë, rihapja e procesit për të vendosur edhe një herë konstatimin e cenimit të së njëjtës së drejtë për të njëjtën çështje nuk e rivendos kërkuesen në situatën që ishte përpara shkeljes së konstatuar, ndaj kërkesa është haptazi e pabazuar.

13. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesja nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenin 71/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës.